

Ne perputhje me Nenin 28 paragrafi 3 i Ligjit 9723/2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit" ky dokument perben:

AKTIN E THEMELIMIT

DHE

STATUTIN

E SHOQERISE

"Koenigstein Albania" Sh.p.k.

TIRANE / SHQIPERI

A handwritten signature or stamp, possibly a stylized 'S' or 'K', located in the bottom left corner of the page.

AKTI THEMELIMIT

DHE

STATUTI

Shoqerise me pergjegjesi te kufizuar

“Koenigstein Albania” Sh.p.k

KAPITULLI I

DATA E THEMELIMIT, FORMA LIGJORE, EMERTIMI, KOHEZGJATJA, OBJEKTI, SELIA E SHOQERISE

Neni 1

Data e Themelimit

Me efekt nga data 13.09. 2018 themelohet Shoqeria “Koenigstein Albania” Sh.p.k ketu e me poshte referuar “Shoqeria”, e ndjekur ne menyre te pandashme shkurtimi “Sh.p.k”, i cili perfaqeson formen ligjore te saj si shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

Neni 2

Forma Juridike

Ne mbeshtetje te vullnetit te aksionerit themelues, si dhe ne pajtim te plote me dispozitat e Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, themelohet Shoqeria Tregtare “**Koenigstein Albania**” Sh.p.k ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar me oferte private, e cila do te funksionoje sipas dispozitave te Aktit te ketij Statuti.

Neni 3

Emertimi

Emertimi i shoqerise eshte “**Koenigstein Albania**” Sh.p.k. dhe ne vazhdim do te referohet si “**Shoqeria**”. Ne te gjitha aktet qe do te nxjerre shoqeria drejtuar te treteve si dhe ne te gjitha aktet e brendshme te saj, do te shenohet detyrimisht emri “**Koenigstein Albania**” Sh.p.k.

Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise

Afati kohor i zhvillimit te aktivitetit eshte i pakufizuar.

Ortaket e Shoqerise mund te vendosin kufizimin e afatit te veprimtarise dhe me pas zgjatjen e saj nje apo disa here, sipas nje vendimi te posaçem.

Neni 5

Objekti i veprimtarise

Objekti i Shoqerise eshte:

- Blerja, ndertimi, rikontruksioni I godinava civile, industriale, turistike, bujqesore, ujesjellesa, kanalizime e vepra te ndryshme arti.
- Importi eksporti I mallrava te ndryshem industriale, ushqimore, pije te ndryshme alkalike dhe joalkolike, tekstile, pajisje hidrosanitare dhe ndertimi, pajisje elektroshtepiake, mobilje etj.
- Menaxhimi I koplekseve turistike, hoteleve, bareve, restoranteve dhe cdo amjenti aktivitetit tjetër shërbimi në funksion të turizmit.
- Shoqeria do të kryejë cdo veprimtari të lejuar nga ligji dhe ose pjesëmarrjen në cdo veprim apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit Shqiptar për fushën e konsulencës ligjore dhe financiare.

Per kryerjen e aktiviteteve qe kerkojne licensim, Shoqeria merr persiper qe me krijimin e saj si person juridik te ndermarre te gjithë hapat e nevojshem prane organeve kompetente per marrjen e licensave perkatese.

Shoqeria ka te drejte te themeloje filiale ose dege brenda vendit dhe te bleje pjesemarrje ne çfaredolloj menyre ligjore ne shoqeri te tjera tregtare, si dhe te realizoje projekte tregtare sebashku me subjekte te tjera tregtare.

Shoqeria mund te hyje ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

Neni 6

Selia e Shoqerise

Selia e Shoqerise ndodhet ne qytetin e Tiranës, ne adresen Rruga "Peti", Pallati 5, Kati I pare.

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne te gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Asambleja e Ortakëve mund te krijojë ose te mbyllë dege dhe/ose zyra perfaqesimi ne Shqiperi dhe jashte saj.

KAPITULLI II KAPITALI THEMELTAR, PJESET NDRYSHIMET E KAPITALIT

SEKSIONI I KAPITALI THEMELTAR



Neni 7

Kapitali i Shoqerise

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 leke (njqind mije leke).

Kapitali i ortakeve eshte i ndare ne 1 (nje) pjese me vlere nominale prej 100.000 leke (njqind mije leke) secila. Pjeset jane te numeruara nga 1 deri 100 pjese.

Ortak I vetem themelues eshte Ervin Çiraku i cili zoteron 100% te vleres se pjeseve ne kapitalin fillestar te Shoqerise te barabarte me 1 (nje) numer pjesesh me kontribut ne vleren 100.000 leke (njqind mije leke).

SEKSIONI II

PJESET

Neni 8

Qdo pjese eshte e pandashem dhe perben te drejten e nje vote.

Pjeset mund te transferohen ne perputhje me ligjet dhe dispozitat e parashikuara ne Statut.

Neni 9

Regjistri i Pjeseve

Pronesia e pjeseve vertetohet nga regjistrimi i tyre ne emer te pronareve ne regjistrin e mbajtur per kete qellim nga Shoqeria, sipas menyres te parashikuar me ligj. Ne regjistrin e pjeseve duhet te regjistrohen te dhenat e zoteruesve te pjeseve te Shoqerise, si emri e mbiemri i ortakut, apo emri i regjistruar nese eshte person juridik, vlere nominale e pjeses, adresa e banimit apo zyra qendrore e ortakut dhe data e kryerjes se regjistrimit, gjithashtu dhe njoftimet ne lidhje me transferimin e kesaj pjese kundrejt paleve te treta, duhet te regjistrohen se bashku me daten e hyrjes.

Me kerkesen e ortakut, Shoqeria leshon nje vertetim te regjistrimit te pjeseve ne pronesi te tij. Administrated i Shoqerise eshte pergjegjes per mbajtjen e regjistrin te pjeseve sipas ligjit.

Neni 10

Pronesia dhe kalimi i pjeseve

Ortaket fitojne te drejta mbi pjeset e tyre nepermjet kontributit ne kapitalin e shoqerise ne castin e krijimit te shoqerise.

Pronesia mbi pjeset fitohet edhe nepermjet shitblerjes, trashegimise, dhurimit apo menyrave te tjera te parashikuara nga ligji.

Qdo transferim i pjeseve te Shoqerise duhet t'i nenshtrohet miratimit te ortakeve. Transferimi i pjeseve te Shoqerise ne favor te nje te treti jo ortak eshte objekt i te drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere, te cilet mund ta ushtrojne kete te drejte brenda 20 diteve nga data e letres se derguar me poste rekomande, e cila permban oferten perkatese. Dispozitat e ketij neni nuk zbatohen ne lidhje me shitjet dhe transferimet e kryera ndennjet ortakeve. Sidoqofte, ne kete rast, transferimi duhet t'i komunikohet paraprakisht me shkrim ortakeve te tjere. Te gjitha njoftimet e parashikuara ne kete Nen, duhet t'i dergohen gjithashtu edhe Shoqerise.



Neni 11

Te drejttat dhe detyrimet e lidhura me pjeset

Çdo pjeset jep te drejten e pjesemarrjes ne fitimet vjetore te shoqerise te destinuara per shperndarje dhe ne tepricen e aktivitet te mbetur ne rastin e likuidimit ne perpjesetimit me pjeset qe zoteron. Pronesia mbi pjeset jep edhe te drejten e votes dhe te perfaqesimit ne mbledhjet e asamblese se pergjithshme ne kushtet e percaktuara ne ligj dhe ne Statut.

Ortaku pergjigjet per detyrimet e shoqerise ndaj te treteve dhe per humbjet e saj deri ne masen e shumes nominale te pjeseve qe ai zoteron. Ndalohet kerkimi i fondeve pertej kesaj shume.

Kur pjeset u kalojne ortakeve te rinj, keta ruajne te drejttat e detyrimet qe vijne nga pjeset.

SEKSIONI III

NDRYSHIMET E KAPITALIT

Neni 12

Zmadhimi i kapitalit themeltar

Kapitali themeltar i Shoqerise mund te zmadhohet sipas menyrave dhe rregullave te parashikuara ne nenet 168 deri 180 te Ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Me perjashtim te rastit te parashikuar ne nenin 176 te ligjit te mesiperem, zmadhimi i kapitalit themeltar mund te behet vetem me Vendim te Asamblese se Pergjithshme e cila vendos me tre te katertat e votave te ortakeve qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te pjeseve me te drejte vote apo perfaqesuesit e tyre, te cilet marrin pjese ne votim personalisht ose votojne me shkrese apo me mjete elektronike.

Kapitali themeltar nuk mund te zmadhohet nese nuk jane shlyer ende kontributet per pjeset e nenshkruara me pare.

Administratoret jane te detyruar te njoftojne per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit vendimin per zmadhimin e kapitalit.

Kapitali themeltar zmadhohet dhe duke emetuar apjese rishtazi, kundrejt kontributeve te reja. Ortaket e Shoqerise kane te drejten e parablerjes per keto aksione ne perpjesetimit me pjesen e kapitalit te regjistruar, qe perfaqesojne pjeset e zoteruara prej tyre.

Asambleja e Pergjithshme mund te vendose zmadhim te kufizuar te kapitalit qe kryhet me emetim te pjeseve te reja, per t'u nenshkruar vetem nga ortaket ekzistues. Zmadhimi i kufizuar i kapitalit mund te kryhet vetem me miratim unanim te te gjithë ortakeve.

Nje forme tjeter e zmadhimit te kapitalit eshte edhe zmadhimi i autorizuar i kapitalit qe mund te kryhet sipas percaktimit ne statut ose sipas nje vendimi te asamblese per ndryshime ne statut duke i dhene te drejte administratoreve per te kryer brenda nje afati 5 vjeçar nga regjistrimi fillestar, zmadhimin e kapitalit me emetim te pjeseve te reja, per nje vlere maksimale te percaktuar (kapital i autorizuar).

Zmadhimi i kapitalit kryhet edhe me aktive te Shoqerise. Pas miratimit te bilancit te vitit paraardhes, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose ta zmadhoje kapitalin e regjistruar, duke kaluar ne kapitalin baze rezervat e disponueshme, fitimet e pashperndara, apo pjese nga fondi rezerve kur eshte kaluar masa prej 10% e tij. Ortaket kane te drejte te zoterojne pjeset e emetuara rishtazi ne perpjesetimit me pjeset e tyre perpara zmadhimit te kapitalit. Çdo vendim i Asamblese se Pergjithshme, qe bie ndesh me kete dispozite, eshte i pavlefshem.

Neni 13



Zvogelimi i kapitalit themeltar

Zvogelimi i kapitalit themeltar te Shoqerise kryhet me Vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve te Shoqerise dhe ne pajtim me dispozitat e neneve 181 deri 186 te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Zvogelimi i kapitalit themeltar mund te behet vetem me Vendim te Asamblese se Pergjithshme e cila vendos me tre te katertat e votave te ortakeve qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te pjeseve me te drejte vote apo perfaqesuesit e tyre, te cilet marrin pjese ne votim personalisht ose votojne me shkrese apo me mjete elektronike.

Zvogelimi i kapitalit realizohet nepermjet zvogelimit te vleres nominale te pjeseve.

Zvogelimi i kapitalit themeltar nuk duhet te cenoje raportin e ortakut para ketij zvogelimi.

Kapitali themeltar nuk mund te zvogelohet nen shumen minimale te kerkuar nga ligji.

KAPITULLI III ORGANET E SHOQERISE

Neni 14

Shoqeria perbehet nga organet e meposhtme:

- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve;
- Drejtori i Pergjithshem (Administratori).

SEKSIONI I ASAMBLEJA E PERGJITHSHME

Neni 15

Mbledhjet e Asamblese dhe efektet detyruese te vendimeve

Te drejtat e ortakeve, per ceshtjet e lidhura me veprimtarine e funksionimit te Shoqerise ushtrohen nepermjet Asamblese se Pergjithshme. Çdo assemble e mbledhur rregullisht perfaqeson teresine e pjeseve te zoteruara nga ortakut. Vendimet e marra nga Asambleja e Pergjithshme ne perputhje me rregullat e percaktuara ne kete statut dhe nga ligji kane fuqi detyruese edhe per ata ortake qe kane votuar kunder.

Neni 16

Te drejtat dhe detyrimet e Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet e meposhtme te Shoqerise:

- percaktimin e politikave tregtare;
- ndryshime te statutit;
- emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar;
- miratimin e skemes se shperblimeve per likuiduesit, ekspertet kontabel te autorizuar;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- shperndarjen e fitimeve vjetore;
- zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar;
- pjesetimin e pjeseve dhe anullimin e tyre;
- ndryshime ne te drejtat, qe lidhen me pjese te llojeve e kategorive te vecanta;

- riorganizimin dhe prishjen e Shoqerise;
- miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te saj;
- miratimin e krijimit, transformimit, shkrirjeje, konsolidimi, shnderrimi, ndarje, riorganizimi, shperndarje, prishjeje dhe mbyllje te filialeve te Shoqerise;
- miratimin e çdo marreveshje apo rregullimi te Shoqerise per te garantuar ne ndonje menyre apo ne çfaredo kushtesh ose per te marre persiper te gjitha ose nje pjese te detyrimeve financiare ose te detyrimeve te tjera te personave/subjekteve te trete;
- miratimin e krijimit te barreve siguruese ose te ndonje lloj barre tjetere ose te drejta te pales se trete mbi çdo Aksion ose Aksioner;
- miratimin e çdo financimi qe tejkalon shumen prej Leke 10.000.000;
- miratimin e çdo financimi qe tejkalon shumen prej 20% te kapitalit sipas vitit ushtrimor parardhes;
- aprovimin e çdo financimi te personave te lidhur; te jape direktiva per administratoret per zbatimin e politikave tregtare te shoqerise;
- te kontrolloje e te mbikqyre zbatimin e politikave tregtare te shoqerise nga administratoret;
- te kujdeset qe shoqeria te respektojte ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- perfaqesimin e shoqerise ne gjykimet ndaj organeve te administrimit;
- te shqyrtojte dhe te kontrolloje librat kontabel, dokumentet dhe aktivet e shoqerise;
- te siguroje se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurise se veprimtarise, si dhe detyrimet e tjera te raportimit e publikimit, te detyrueshme ne baze te ligjit apo statutit, te kryhen me sakte si nga administratoret. Keto dokumente duhet te miratohen e te nenshkruhen nga te gjitha anetaret e asamblese se pergjithshme, se bashku me nje raport dhe nje pershkrim per mbikqyrjen e menaxhimit gjate te gjithë vitit financiar;
- te siguroje se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabel te kryhet te pakten nje here ne vit nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur dhe qe raporti i auditimit, drejtuar asamblese se pergjithshme, t'u vihet ne dispozicion te gjithë anetareve asamblese.
- te emeruje dhe te shkarkoje administratoret, te ndaje kompetencat ndermjet tyre;
- te percaktojte shperblimin e administratoreve;
- te miratoje marrjen persiper te detyrimeve me vlere me te larte se 5 % te asetëve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare, te çertifikuara, nepermjet nenshkrimet te huave apo emetimit te obligacioneve apo instrumenteve te tjera te borxhit;
- te vendose krijimin e bashkepunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, per themelimin e shoqerive tregtare ose te grupeve te reja;
- aprovon shperblimet vjetore te çdo punonjesi;
- aprovon rritje vjetore te pages te çdo punonjes ne baze te relacionit nga Administratori;
- aprovon çdo kontrate sherbimi nga palet e treta ku Shoqeria angazhohet te paguaje mbi shumen 10, 000 EUR (dhjete mije euro) ne vit. Ketu perjashtohen te gjitha kontratat me subjektet te parashikuara ne ligje, udhezime ose rregullore te subjekteve licensues;
- aprovimin e çdo financimi te personave te lidhur;
- te kryeje veprimet e tjera, te percaktuara ne ligj dhe ne statut.

Neni 17

Organizimi i mbledhjeve te Asamblese

Asambleja thirret nga Drejtori i Pergjithshem (Administratori), ose aksioneret qe perfaqesojne te pakten 5 % te kapitalit te regjistruar te shoqerise.



Asambleja e pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit. Asambleja mblidhet ne seline e Shoqerise ose ne çdo vend tjeter te treguar ne thirrje, si brenda territorit te Republikes se Shqiperise, ashtu dhe jashte territorit, sipas percaktimeve te bera ne njoftimin perkates.

Thirrja e Asamblese behet me ane te njoftimit me shkrese ose poste elektronike qe i dergohet aksionereve se bashku me rendin e dites, jo me vone se 21 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen, dhe duhet te permbaje ditën, oren dhe vendin e mbledhjes, natyren e Asamblese dhe rendin e dites.

Kur Asambleja e mbledhur nuk ka mundur te marre vendim per shkak se nuk eshte siguruar kuorumi i kerkuar, mbledhja e dyte thirret jo me vone se nje muaj nga data e thirrjes se pare ne te njejtat forma si e para. Njoftimi ose letrat e thirrjes se mbledhjes se dyte rikujtojne datën dhe rendin e dites.

Neni 18

Rendi i Dites

Rendi i dites te mbledhjes se Asamblese qe njoftohet si me siper, duhet te permbaje edhe vendimet e propozuara per çdo çeshtje.

Nese Asambleja e Pergjithshme duhet te vendose per ndryshimin e statutit, teksti i ndryshimeve duhet te njoftohet se bashku me rendin e dites.

Administratoret duhet t'i pergjigjen me shkrim, çdo kerkese me shkrim per sqarim per rendin e dites, derguar nga aksioneret jo me vone se 8 dite perpara dates se mbledhjes se asamblese se pergjithshme.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas formaliteteve si me siper, ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese te gjithë aksioneret jane te pranishem dhe shprehen dakord per te marre vendime, pavaresisht parregullise.

Neni 19

Evidenca e pjesemarrjes, drejtimi i mbledhjes dhe proces – verbalet

Nje ortak mund te perfaqesohet ne asamblene e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Asambleja e Pergjithshme cakton nje kryetar.

Gjate mbledhjes se Asamblese pergatitet lista e ortakeve te pranishem dhe te perfaqesuesve te tyre ku shenohen emrat dhe adresat e secilit, se bashku me numrin e pjeseve, numrin e votave qe keto pjese japin, vleren nominale te pjeseve si dhe llojin apo kategorine e tyre, te zoteruara nga secili pjesemarrës. Kjo liste nenshkruhet prej tyre.

Ortakët qe nuk jane te pranishem mund te marrin pjese ne mbledhje me mjete te ndryshme komunikimi, perfshire mjete elektronike, me kusht qe te garantohet identifikimi i tyre.

Te gjitha vendimet e asamblese se pergjithshme duhet te regjistrohen ne procesverbal. Procesverbali duhet te permbaje te dhenat vijuese: datën e mbledhjes, vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit dhe te mbajtesit te procesverbalit, rezultatet e votimit, vendimet e marra, qendrimin e kryetarit per vendim-marrjen, si dhe te ortakeve qe jane shprehur kunder. Procesverbalit i bashkelidhen edhe lista e pjesemarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes se asamblese se pergjithshme. Procesverbali dhe lista e pjesemarrësve duhet te nenshkruhen nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverbalit.

Administratoret jane pergjegjes per ruajtjen e procesverbaleve.



Neni 20

Kuorumi

Per çeshtjet qe vendosen me shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme merr vendime te vlefshme, vetem nese jane te pranishem ose te perfaqesuar ortaket, qe zoterojne me shume se 50 % te aksioneve, me te drejte vote. Per çeshtje qe kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 21 me poshte, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme, vetem nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te pjeseve me te drejte vote, apo perfaqesuesit e tyre, marrin pjese ne votim personalisht ose votojne me shkrese apo me mjete elektronike.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorunit te kerkuar, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

Neni 21

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tre te katertat e votave te ortakeve, qe marrin pjese ne votim, ne lidhje me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Per çeshtje te tjera, asambleja e pergjithshme merr vendime me shumicen e votave te aksionereve qe marrin pjese.

Neni 22

Menyra e votimit

Asambleja e pergjithshme merr vendimet, nepermjet votimit te hapur. Per emerimin dhe shkarkimin e Administratorit, asambleja e pergjithshme vendos me votim te fshehte, nese kjo menyre votimi kerkohet nga ortaket, te cilet zoterojne nje numer pjesesh qe perfaqesojne te pakten 10 % te kapitalit te regjistruar te shoqerise.

Neni 23

Venia ne dispozicion te Ortakut te dokumenteve dhe informacioneve

Shoqeria mban ne zyrat e saj librat qe kerkohen nga Ligji, ku do te mbahen llogarite vjetore, tabelat financiare vjetore, bilancet ekonomike vjetore, raportet ekonomike vjetore, ne te cilat duhet te perfshihet dhe çdo gje tjeter qe parashikohet nga ligji. Ajo i ve ne dispozicion te Ortakut ne kushtet dhe afatet e percaktuara ne ligj.

Librat zyrtare te shoqerise dhe tabelat financiare vjetore, bilancet financiare dhe raportet financiare vjetore duhet te mbahen ne gjuhen shqipe.

**SEKSIONI III
ADMINISTRATORET**

Neni 24

Administratoret drejtojnë dhe administrojnë Shoqerine dhe marrin vendime për menyrën e venies në zbatim të politikave tregtare.

Neqoftese nuk vendoset ndryshe nga Asambleja e Përgjithshme, Shoqeria nga data e themelimit të saj do të ketë vetëm një Administrator, i cili për qëllime të organizimit të brendshëm të Shoqerisë do të quhet Drejtor i Përgjithshëm.

Me vendim të posaçëm të Asamblesë së Përgjithshme Administrator i parë/Drejtori i parë i Përgjithshëm është Z. Ervin Çiraku, shtetas shqiptar, i biri i Pellazit, lindur më 05.06.1979 në Vlorë dhe banues në Tiranë, në adresën Rruga "Eduart Mano", Kompleksi "Xhelili", madhor, me zotësi të plote juridike për të vepruar, mbajtes i Letërnjoftimit me Nr. 030972827.

Neni 25

Emerimi dhe shkarkimi

Administratore të Shoqerisë mund të jenë një ose disa persona fizike. Ata emerohen nga Asambleja e Aksionereve për një afat jo më të gjatë se 3 (tre) vjet. Administratoret e Shoqerisë mund të rizgjidhen.

Asambleja e Ortakeve ka të drejtë të shkarkojë administratoret në çdo kohë.

Neni 26

Të drejtat dhe përgjegjësitë

Administratoret kanë të drejtë dhe detyrohen:

- të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqerisë;
- të përfaqësojnë Shoqerinë;
- të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të Shoqerisë;
- të përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin asamblesë së ortakeve për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur me pas për miratim nga Asambleja e Përgjithshme;
- të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të përhershëm për rrethanat, që kërcenojnë ekzistencën e shoqerisë;
- të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhenave të Shoqerisë, sipas parashikimeve të ligjit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare apo të ligjeve të tjera;
- të raportojnë përpara Asamblesë së ortakeve për zbatimin e politikave tregtare dhe për realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e Shoqerisë;
- të kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratoret duhet të informojnë menjëherë asamblesën e ortakeve në rastet kur:

- Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 5 % të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqerisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kerkueshme brenda 3 muajve në vijim.
- Shoqeria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqerisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara.

- Shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit, propozon te bleje, nga nje ortak, pasuri qe kane vlere me te larte se 5 % te asetëve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.

Neni 27

Perfaqesimi i Shoqerise

Administratoret perfaqesojne shoqerine ne lidhje me te tretet. Administratoret te cilet kane te drejte te perfaqesojne shoqerine ne menyre te perbashket, mund te autorizojne disa prej tyre per kryerjen e disa veprimeve te caktuara apo per kryerjen e disa kategorive te caktuara veprimesh.

Tagrat e perfaqesimit te administratoreve dhe çdo ndryshim i tyre regjistrohen prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.

Neni 28

Detyrime dhe pergjegjesi te perbashketa te Asamblese se Ortakeve dhe Administratoreve

Administratoret dhe anetaret e Asamblese se Ortakeve detyrohen:

- te kryejne detyrat e tyre ne mirebesim e ne interesin e shoqerise;
- te ushtrojne kompetencat qe u jep ligji dhe statuti;
- te vleresojne ne menyre te pershtatshme çeshtjet per te cilat merret vendim;
- te parandalojne dhe te menjanojne rastet e konfliktit, te pranishme apo te mundshme te interesave personale me ato te shoqerise;
- te ushtrojne detyrat e tyre me profesionalizem dhe me kujdesin e nevojshem.

Ata pergjigjen ndaj Shoqerise per çdo veprim ose mosveprim gjate kryerjes se detyrave te tyre. Ata pergjigjen ne menyre solidare per vertetesine e te gjitha pasqyrave financiare, te publikimeve te detyrueshme dhe informacioneve te tjera kryesore te veprimtarise se Shoqerise.

Neni 29

Mbikqyrja e veçante

Ortaket te cilet perfaqesojne te pakten 10% te kapitalit baze ose nje perqindje me te vogel te parashikuar ne statut apo kreditorët e shoqerise, pretendimet e te cileve ndaj saj jane te pakten 10% te kapitalit te regjistruar, mund t'i kerkojne Asamblese se Ortakeve te kryeje mbikqyrje te veçante per çeshtje te posaçme, sidomos kur merret ne shqyrtim ligjshmeria e veprimeve te administratoreve.

KAPITULLI IV EKSPERTET KONTABEL TE AUTORIZUAR

Neni 30

Emerimi dhe shperblimi

Asambleja e Pergjithshme ka te drejten per te caktuar nje ose disa eksperte kontabel te autorizuar te zgjedhur nga listat e Institutit te Eksperteve Kontabel te Autorizuar.



Ne caktimin e eksperteve mbahen parasysh perjashtimet dhe papajtueshmerite e percaktuara ne rregullat e posaçme. Ekspertet Kontabel te Autorizuar caktohen per nje kohe qe i pergjigjet nje ushtrimi financiar. Ata jane te ricaktueshem.

Shperblimi i eksperteve kontabel te autorizuar caktohet nga asambleja e pergjithshme dhe perballohet nga shoqeria.

Neni 31

Detyrat dhe te drejtat

Detyrat dhe te drejtat e ekspertit kontabel te autorizuar te Shoqerise jane ato te parashikuara nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Asambleja e Pergjithshme mund t'i kerkoje ekspertit kontabel te autorizuar kryerjen e kontroleve apo verifikimeve te posaçme per çeshtje me interes te Shoqerise. Me marrjen e raportit te ekspertit kontabel te autorizuar Asambleja miraton raportin dhe bilancin e Shoqerise. Raportet qe eksperti i kontabel i autorizuar pergatit depozitohen ne seline e Shoqerise, ne afatet e parashikuara nga ligji.

KAPITULLI V

LLOGARITE VJETORE, CAKTIMI I REZULTATIT

Neni 32

Viti financiar

Shoqeria pergatit çdo vit financiar llogarite vjetore ne pajtim me ligjin per kontabilitetin. Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti.

Neni 33

Caktimi i rezultateve


Rezultati i vitit financiar nxirret dhe caktohet ne pajtim me legjislacionin ne fuqi dhe mbas dhenies se raportit perfundimtar nga eksperti kontabel i autorizuar.

Neni 34

Fitimet dhe fondi i rezerves

Fitimet qe rezultojne nga bilanci i miratuar do te shperndahen sipas nje vendimi perkates te Asamblese ndermjet ortakeve pasi te jene zbritur nga kjo shume taksat dhe tatimet sipas ligjit, vlere e humbjeve te pesuara gjate vitit ushtrimor paraardhes si dhe 5% (pese perqind) e kesaj vlere qe kalon ne fondet e rezerves se domosdoshme, derisa kjo rezerve te kete arritur nivelin maksimal prej 1/10 e kapitalit te regjistruar te Shoqerise.

Ortaket mund te vendosin sipas ligjit per nje destinim te ndryshem te fitimit te pashperndare. Me vendimin e miratimit te bilancit ushtrimor, Asambleja e Pergjithshme mund te vendose t'i destinoje fitimet qe i takojne ortakeve ne forme dividendi, per zmadhim te kapitalit themeltar, investime ose mbartje, etj.



KAPITULLI VI PRISHJA, LIKUIDIMI, KUNDERSHTIMET

Neni 35 Prishja, likuidimi

Shoqeria priset:

- kur mbaron kohezgjatja per te cilen eshte themeluar;
- kur merr vendim Asambleja e Pergjithshme;
- me hapjen e procedurave te falimentimit;
- kur nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit;
- me vendim gjykate.

Shoqeria likuidohet ne dy menyra, likuidimi i zakonshem dhe likuidimi i thjeshtezuar. Likuidimi i zakonshem kryhet nga likuiduesit e emeruar nga asambleja e pergjithshme. Ne rast se asambleja nuk merr vendim per caktimin e likuiduesit ai zgjidhet nga gjykata. Detyra e likuiduesve eshte mbyllja e te gjitha veprimeve te shoqerise, mbledhja e kredive te paarketuara dhe e kontributeve te pashlyera, shitja e pasurive te shoqerise dhe shlyerja e kreditoreve.

Nese, ne baze te padive te ngritura nga kreditoret, likuiduesit verejne se pasuria e Shoqerise, perfshire kontributet e pashlyera, nuk eshte e mjaftueshme per pagesen e ketyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojne proceduren e likuidimit e t'i kerkojne gjykates perkatese nisjen e procedurave te falimentimit.

Likuiduesi pergatit nje bilanc te gjendjes se Shoqerise ne castin e hapjes se likuidimit dhe nje bilanc perfundimtar ne castin e mbylljes se ketyre procedurave. Nese procedura e likuidimit zgjat me shume se nje vit, likuiduesi pergatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore te Shoqerise. Bilancet miratohen nga asambleja e pergjithshme.

Pas shlyerjes se detyrimeve ndaj kreditoreve, likuiduesi u shperndan ortakeve aktivet e mbetura, sipas te drejtave qe ata kane ne ndarjen e fitimeve.

Pas shperndarjes se aktiveve te mbetura, likuiduesi e njofton Qendren Kombetare te Regjistrimit per perfundimin e likuidimit dhe kerkon çregjistrimin e shoqerise.

Persa i perket likuidimit te thjeshtezuar ky mund te kryhet nepermjet nje procedure te pershpjettuar, nese kjo vendoset nga te gjitha ortaket dhe kur keta deklarojne perpara gjykates perkatese se te gjitha detyrimet e shoqerise ndaj kreditoreve jane shlyer e jane rregulluar te gjitha marredheniet me punemarresit.

Administratoret njoftojne per regjistrim prane Qendres Kombetare te Regjistrimit vendimin per likuidimin e shoqerise, nepermjet procedures se thjeshtezuar, gjithashtu ata jane pergjegjes per demin e shkaktuar nga shkelja e detyrave te tyre gjate likuidimit te thjeshtezuar.

Neni 36 Zgjidhja e mosmarreshjeve

Te gjitha mosmarreshjet gjate funksionimit te Shoqerise ose gjate likuidimit te saj qe linden midis Shoqerise dhe Ortakut ose midis vete Ortakeve, lidhur me veprimtarine e Shoqerise, i nenshtrohen juridiksionit te gjykatave kompetente ne kushtet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.



KAPITULLI VII DISPOZITA TE FUNDIT

Neni 37

Nepunesit, te zgjedhurit nga organet drejtuese te Shoqerise dhe personat qe punojne per llogari te saj, mbajne pergjegjesi penale e civile sipas ligjit perkates kur me dashje shkelin detyrat e ngarkuara e i shkaktojne humbje Shoqerise.

Neni 38

Ky Statut eshte hartuar dhe rregullohet sipas legjislacionit shqiptar.

Statuti hyn ne fuqi mbas nenshkrimit te tij dhe regjistrimit te Shoqerise ne Regjistrin Tregtar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Gjithçka qe nuk eshte parashikuar shprehimisht ne kete Statut do te disiplinohet nga legjislacioni tregtar dhe ligje te tjera te lidhura me te ne fuqi ne Republiken e Shqiperise, ne vecanti nga Ligji Nr. 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Neni 39

Kjo Shoqeri do te filloje te funksionoj me kusht miratimin e veprimtarise se saj nga autoritetet perkatese shqiptare, ne baze te legjislacionit ne fuqi dhe vetem me kete kusht.


Neni 40

Ky Statut perpilohet ne 5 (pese) kopje ne gjuhen shqipe.

Statuti i Shoqerise pasi u lexua nga Ortaket e Shoqerise u nenshkrua prej tij pa verejtje.

ORTAKET E SHOQERISE :

Ervin Çiraku

A handwritten signature in black ink, appearing to read 'Ervin Çiraku', written over a printed name. The signature is stylized and somewhat cursive.